



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 309/24
Data 21.04.24

Prishtinë, 2 prill 2024

Kodi i ZRRE: V_1928_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3, Nenit 48 dhe 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën Nr. 03/2017 për Vendosjen e Të hyrave të Lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (SHST) dhe Taksave të Kyçjes;
- Vendimin V_1922_2024 të datës 22 mars 2024 për aprovimin e Të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (OST/OT);
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST);
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut; dhe
- Propozimin e OST/OT për miratimin e tarifave të OST/OT në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, të dorëzuar më datën 28 mars 2024,

në seancën e mbajtur më 2 prill 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimi të Sistemit dhe Operimi të Tregut, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT).
- II. Struktura e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimi të Sistemit dhe Operimi të Tregut është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij vendimi:

Grupi tarifor	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	Tarifat 2024
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	2.997
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.024
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.514
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.024
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	2.850
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.024
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	7.040
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	15.440
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	2.850
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.024
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	3.039

- III. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT) duke filluar nga data 1 prill 2024 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 12 dhjetor 2023 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të Të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (OST/OT).
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i azhurnimeve vjetore i Të Hyrave dhe Tarifave për vitin relevant tarifor 2024 ka për qëllim të vendos Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarit OST/OT, për periudhën 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025.
- ZRRE me datë 22 janar 2024 nga Operatori Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A ka pranuar aplikacionin për Të Hyrat e Lejuara Maksimal për vitin relevant tarifor 2024.
- ZRRE me datë 6 shkurt 2024 ka publikuar vlerësimin fillestar të aplikacionit lidhur me Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

(OST/OT), ku i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

- ZRRE më datë 21 shkurt 2024 ka pranuar komentet nga OST/OT dhe palët e interesit lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT.
- Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, përfshinë edhe të dhënat e përditësuara nga OST/OT. ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka marrë në konsideratë përditësimet e bëra dhe çështjet e ngritura nga të gjitha palët e interesit në procesin e konsultimit publik.
- ZRRE 22 mars 2024 me anë të vendimit V_1922_2024 ka aprovuar Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin relevant tarifor 2024.
- ZRRE më datë 28 mars 2024 nga OST/OT ka pranuar propozimin për Tarifatat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimin e Sistemit, Operimin e Tregut dhe Tarifën për Fondin e Burimeve të Ripërtërishme.
- Tarifatat e propozuar nga OST/OT janë kalkuluar në pajtueshmëri me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST); Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit dhe Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut. Propozimi i OST/OT për tarifatat e OST/OT-së është i bazuar në Vendimin e ZRRE-së për Të Hyrat e Lejuara Maksimale V_1922_2024 të datës 22 mars 2024.
- Tarifatat e propozuara nga OST/OT, reflektojnë kostot e shërbimit për aktivitetet e Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit, Operimit të Tregut dhe Fondit të Burimeve të Ripërtërishme në përputhje me Rregullën Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifatat e Shfrytëzimit të Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut, ka vlerësuar se kërkesa është e bazuar në Vendimin V_1922_2024 të datës 22 mars 2024 për të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KOSTT
- KEDS,
- KESCO, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.